



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:019046

Datë: 01.11.2021

Numri i dokumentit: 02344927

C.nr.102/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Berat Spahiu me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A...G.. nga Gj..., të cilën e përfaqëson me autorizim F.. S.... avokat nga Gj....., kundër të paditurës S.... i P... në Gj..., me objekt kontesti: për pagesën e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit prej 1,011.20 euro, jashtë seancës, më datën 01.11.2021, mori këtë:

AKTGJYKIM

APPROVOHET në tërësi si e bazuar kërkespadija e të paditëses A... G...nga Gj.... dhe **DETYROHET** e paditura S.... i P.... në Gj..., që paditëses t'ia paguajë shumën prej 1,011.20 euro në emër të të pagesës së shpërblimit jubilar në vlerë të dy (2) pagave mujore, me kamatëvonesë vjetore prej 8% në vit, duke filluar nga data 28.01.2021 deri në pagesën përfundimtare si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë shumën prej 134.00 euro, afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja A.... G.. nga Gj....., me datën 28.01.2021, përmes të autorizuarit të saj F.. S...., avokat në Gj..., ka paraqitur padi kundër të paditurës S..... i P.... në Gj..., me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit prej 1,011.20 euro. Në padi paditësja ka theksuar se është në marrëdhënie pune te e paditura si Infermiere në Q... e Sh.... M... me Sh..... për I... në B..... në Gj..., duke theksuar se e njëjta ka përvojë pune mbi 20 vite. Kërkesën e saj paditësja e ka bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (më tej: KKS), konkretisht në nenin 17 pargarfi 3, nën par. 3.1 duke theksuar se mbi 20 vite të përvojës së punës të njëjtës i takon pagesa e shpërblimit jubilar në vlerë të dy (2) pagave mujore në shumë prej 1,011.20 euro. Meqenëse e paditura nuk i ka paguar vullnetarisht mjetet të cilat ka qenë e obliguar t'i paguaj, paditësja kërkon nga gjykata që të aprovohet si e bazuar kërkespadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura t'ia paguaj shumën prej 1,011.20 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së kësaj padisë. Gjithashtu e njëjta i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar edhe ate: për hartimin e padisë shumën prej 104.00 euro si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar kërkespadinë, duke theksuar duke theksuar se Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, në cilësinë e autoritetit më të lartë menaxhues në Sektorin e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së

Kosovës në cilësinë e përfaqësuesve të punëtorëve shendetësore, kanë lidhur Kontratën Kolektive Sektoriale më datë 11.06.2018, e cila i obligon Institucionet Shendetësore që ta zbatojnë këtë por që paraprakisht me rastin e aprovimit të buxhetit të Kosovës për këtë sektor të sigurohen mjete financiare. Kurse nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe faktet vendimtare, se paditësi është në mardhënie të punës tek e paditura, se ka mbi 20 vite përvojë të punës, se realizon të ardhura mujore në lartësi prej 505.60€.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka ohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohura konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyër meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, repsektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në mardhënie pune tek e paditura, se ka mbi 20 vite përvojë të punës, se realizon të ardhura mujore në lartësi prej 505.60€, dhe se Kontrata Kolektive Sektoriale me nr.05-3815 e datës 12.06.2018 në nenin 17 pika 3 e saj e ka rregulluar këtë materie, pasi që në nenin përkatës shprehimisht është përcaktuar se *“Punëtorët shendetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shendetësore, në vlerë të një page mujore të tij; Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shendetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shendetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Me paragrafin 4 të kësaj Kontrata, përcaktohet se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se të njejtës i ishte premtuar se pas rishikimit të buxhetit do t’i ndaj një pjesë e mjeteve pikërisht për implementimin e kësaj kontrate, për gjykatën një pretendimi i tillë është jorelevant, pasi që e njejtja është nënshkruese e kësaj kontrate dhe duhet t’i përmbushë obligimet që ka ndaj punëtorëve.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ *Ligji nr. 04/L-077 date 19.06.2012/*, ku shprehimisht është përcaktuar se *„ Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 30.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
C.nr.102/2021, dt.01.11.2021

Gjyqtari,
Berat Spahiu

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.